

RETURN 2 LEARN PLAN

PROTOKOLLET E RRETHIT SHKOLLOR TROY PËR COVID-19

MANUAL PËR FAMILJET

PËRDITËSUAR MË 10.1.21

**Ky manual për familjet është aktual duke filluar nga
10/1/2021.**

**Ju lutem të kontrolloni faqen e internetit të Rrethit
Shkollor Troy për manualin më të fundit.**

PËRMBLEDHJE

Rrethi Shkollor Troy e kupton rëndësinë që ka mbajtja e studentëve në klasa për mësim më vete ndërkohë që mbron shëndetin dhe sigurinë e shkollave dhe të komunitetit tonë. Ky plan ka për qëllim t'i japë familjeve dhe stafit informacion se cilat protokolle do të vendosen, ku bazohen ato protokolle teksa vazhdojmë të mbrojmë nga përhapja e COVID-19.

Do të fillojmë vitin shkollor 2021-22 duke zbatuar një urdhër shëndetësor të Oakland County, në të cilin kërkohet mbajtja e maskave (informacione të mëtejshme për këtë gjenden te pjesa e mjeteve personale mbrojtëse ose PPE) por ka edhe masa të tjera sigurie. Këto do të na ndihmojnë të arrijmë synimet tona:

- T'i kthejmë studentët te mësimi në banka, ballë për ballë
- Të implementojmë protokolle sigurie për të mbrojtur sa më shumë të jetë e mundur komunitetin e shkollës sonë; dhe
- Të ruajmë mjedisin e mësimi ballë për ballë.

Është shumë e rëndësishme që jo vetëm ta fillojmë vitin shkollor me mësimin ballë për ballë, por edhe të jemi në gjendje t'i mbajmë studentët në klasa pa ndërprerje. Masat e sigurisë që kemi, janë teprë të rëndësishme për të pakësuar numrin e studentëve që duhet të futen në karantinë dhe në ruajtjen e mësimi ballë për ballë.

Njëlloj siç bëmë vitën e kaluar, ky vit shkollor duhet të shihet si një disk rrotullues, në të cilin kushtet e COVID-19 në rreth dhe në rajon na kërkojnë që "të rrotullojmë diskun para ose mbrapa" për të parandaluar përhapjen e virusit. Gjithashtu do t'u përmbahemi të gjitha mandateve lokale, shtetërore ose federale.

Protokollet në këtë manual për familjet mund të ndryshohen gjatë vitit shkollor dhe manuali do të përditësohet hde postohet në faqen e internetit. Familjet, stafi dhe studentët do të informohen për çdo ndryshim.

Lista e mëposhtme tregon parametrat kryesore që shohim për të marrë vendime lidhur me COVID-19.

PARAMETRAT DHE TRENDET

Përhapja e COVID-19 në komunitet: siç është matur nga përqindja e testeve pozitive*

Mesatarja 7-ditore dhe 14-ditore e rasteve të reja në Rrethin Oakland*

Totali dhe trendi i rasteve në Rrethin Oakland në grupmoshën 0-19 vjeç (ose 5-19)

Mesatarja 14-ditore e rateve të reja brenda kufijve të Rrethit Shkollor Troy (për 10,000 banorë)

Kapaciteti i sistemit shëndetësor/Përqindja e rasteve të shtrimeve në spital në 14 ditët e fundit

Të gjitha grupet e të dhënave të mësipërme mund të gjenden në <https://www.oakgov.com/covid/resources/education/Pages/data.aspx> dhe në skedën “Rastet aktuale sipas rrethit shkollor”: <https://www.oakgov.com/covid/casesByZip.html>

Gjithashtu, një aspekt i rëndësishëm i përjekjeve tona është monitorimi nga afër i normës së transmetimit CDC në zonën tonë: <https://covid.cdc.gov/covid-data-tracker/#county-view>

Kjo normë transmetimi CDC është një faktor i rëndësishëm në Urdhrin e OCHD për Shëndetin dhe ka ndikim të madh në përpjekjet tona për lehtësimin e situatës. Norma e transmetimit CDC bazohet në dy metrikat tona të para të renditura (dhe të shënuara me yll) më sipër.

**Këto janë metrikat kryesore që përdoren në vendimmarrjen për sigurinë dhe lehtësimin e situatës.*

MODELI MËSIMOR

Rrethi Shkollor Troy beson se është e rëndësishme që studentët tanë të bëjnë mësim ballë përballë, brenda klasave, kurdoherë që është e mundur. Kjo u sjell dobi studentëve në fushën akademike, sociale dhe emocionale. TSD do të kthehet në një ditë shkollore të zakonshme në të gjitha nivelet, e cila përfshin një ditë prej gjashtë periudhash në shkollën e mesme. Lëndët speciale do të bëhen ballë për ballë në shkollën fillore.

Nëse familjet kanë rrethana të veçanta ku mësimi ballë për ballë nuk është i rehatshëm për studentët e tyre, kemi mundësi të kufizuara për mësim virtual. Studentët që zgjedhin opsionin virtual duhet të regjistrohen për një simestër (në nivelin e shkollës së mesme, bërja e më pak se një semestri nuk të jep kredit për kursin.) Ju lutem të kontaktoni drejtorin e shkollës për më shumë informacion në lidhje me një opsion virtual.

MASAT LEHTËSUESE PËR TË MBROJTUR SIGURINË DHE SHËNDETIN

Do të ketë shumë shtresa mbrojtëse për studentët dhe stafin për vitin shkollor 2021-22. Në varësi të kushteve të COVID-19 në zonën tonë, ose do të implementojmë masa lehtësuese shtesë, ose do të heqim disa gjatë vitit shkollor. Çdo ndryshim do të publikohet në faqen tonë të internetit dhe do t'u komunikohet familjeve më përpara. Më

poshtë është një përmbledhje e shpejtë e masave lehtësuese që ekzistojnë aktualisht. Informacione të hollësishme gjenden në këtë manual për familjet.

Maskat/PPE	Kërkohen për të gjithë studentët dhe stafin në ndërtesat tona. Maskat janë gjithashtu të nevojshme në shkollat e autobuzëve, sipas urdhrit federal. Nuk kërkohet mbajtja e maskave jashtë.
Distancimi fizik	Studentët do të distancohen sa më lart të jetë e mundur dhe do të përdoren hapësira alternative aty ku është e mundur. Nuk mund të garantohet distancë minimale.
Kontrolli shëndetësor ditor	Pritet që prindërit t'i kontrollojnë çdo ditë studentët e tyre për të parë nëse ekzistojnë simptoma të sëmundjes dhe t'i mbajnë ata në shtëpi nëse kanë simptoma. Për momentin, nuk do të kërkohen kontrole online.
Vaksinimet	TSD i nxit fort të gjithë studentët e pranueshëm dhe stafin që të vaksinohen plotësisht. Menjëherë sapo studentët e rinj të kenë mundësi të vaksinohen, do të jepet njoftimi.
Ajrimi	TSD do të vazhdojë të përdorë sistemet tona të avancuara të ajrimit për t'u siguruar që në ndërtesa të qarkullojë vazhdimisht ajri i jashtëm gjatë ditës. Kur moti është i përshtatshëm, dritaret në autobusë do të mbahen të hapura për të rritur qarkullimin e ajrit të jashtëm.
Sëmundja	Studentët dhe stafi duhet të qëndrojnë në shtëpi kur janë të sëmurë. Të gjitha mungesat duhet të raportohen nëpërmjet sistemeve tona të pjesëmarrjes. Çdo simptomë që mund të ketë lidhje me COVID-19 duhet t'u raportohet shkollave.
Pastrimi dhe dezinfektimi	Pastrimi i të gjitha ndërtesave, duke përdorur produkte të miratuara nga EPA, do të bëhet çdo ditë. Në rast se dallohet një rast i COVID në klasë, ajo zonë do të dezinfektohet brenda së njëjtës dite.
Karantina	OCHD do të punojë me TSD për të urdhëruar karantinën. Në të gjitha ndërtesat do të përdoren grafikë për karriget.Me mbajtjen universale të maskës, distanca nga afër do të reduktohet në 3 feet (1 metër).Studentëve dhe stafit që janë vaksinuar plotësisht nuk u kërkohet të karantinohen nëse nuk kanë simptoma.
Dreka	Studentët do të distancohen sa më shumë të jetë e mundur nga njëri-tjetri. Në shkollën fillore, studentët do të ulen me grupin e klasës

	së tyre, megjithatë grupet nuk do të përdoren në pushim. Në të gjitha nivelet, do të përdoren hapësira alternative aty ku është e mundur. Hapësira e jashtme do të përdoret për drekën kur kushtet e motit e lejojnë dhe kur mund të garantohet mbikëqyrja e mirë.
Udhëtimi ndërkombëtar	Aktualisht nuk ka kërkesa për karantinë në udhëtimet ndërkombëtare. I nxitim të gjitha familjet që udhëtojnë qoftë jashtë vendit, qoftë brenda vendit, që të kenë kujdes dhe t'i kontrollojnë studentët e tyre për sëmundje.
Dita e shkollës	TSD do të kthehet në një ditë shkollore të zakonshme në të gjitha nivelet, e cila përfshin një ditë prej gjashtë periudhash në shkollën e mesme. Lëndët speciale do të bëhen ballë për ballë në shkollën fillore. Ekskursionet do të aprovohen me vendim të administratës. Do të shmangen grumbullimet e të gjithë personave në ndërtesë, megjithatë do të lejohen mbledhjet në shkollën e mesme, duke përdorur hapësira të mëdha dhe sa më shumë distancë mes studentëve. Eventet e jashtme, si dita në fushë, vrapimet argëtuese, etj. do të mbahen.
Muzika instrumentale dhe vokale	Për instrumentet muzikore, do të sigurohen mbulesa. Do të sigurohen maska speciale në formë konike për korin dhe për orët e muzikës.
Atletika	TSD do të ndjekë MHSAA për rregullat në lidhje me konkurset e atletikës dhe stërvitjen. I nxitim të gjithë studentët e atletikës që të vaksinohen plotësisht dhe të karantinohen kur ekspozohen.
Vizitorët në shkollat tona	Numri i vizitorëve në shkolla do të jetë i kufizuar. Prindërit që kanë takime (mbledhjet IEP, takimet me mësuesin ose administratorin, etj.) janë të mirëpritur në godina. Derisa të dhënat për COVID-19 të përmirësohen, vizitat jo të domosdoshme (për shembull, për të ngrënë drekë me një student) nuk do të lejohen. Janë duke i zhvilluar protokolle për vullnetarët. Eventet në shkallë të gjerë, ku pritet të marrë pjesë një publik i gjerë, si për shembull netët e kurrikulës, do të jenë virtuale.
Larja e duarve dhe higjiena	Larja e duarve dhe higjiena e mirë është diçka që do të nxitet dhe inkurajohet shumë. Do të sigurohen mjete të tilla si, sapun dhe higjenzant duarsh.

CILAT JANË SIMPTOMAT E COVID-19?

Simptomat mund të shfaqen brenda 2-14 ditësh pas ekspozimit ndaj virusit. Simptomat më të shpeshta janë:

- Ethe/temperaturë (100.4 °F ose 38.8 °C, ose më e lartë)
- Dhimbje në muskuj ose trup
- Rufë ose sekrecione nga hundët
- Humbje e ndjesisë së shijimit
- Gulçim/vështirësi në frymëmarrje
- Kollë
- Dhimbje fyti
- Këputje
- Diarre (2 herë në 24 orë)
- Përzierje/të vjella (2 herë në 24 orë)

PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE DHE FAMILJEVE

PËRGJEGJËSITË E PRINDËRVE/KUJDESTARËVE PËR KTHIMIN TE MËSIMI BALLË PËR BALLË

Është e nevojshme të kuptohet se mësimi ballë për ballë gjatë një pandemie përfshin përgjegjësinë e përbashkët për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e të gjithë studentëve dhe të stafit, si dhe t'u përmbahemi me rreptësi rregullave të caktuara.

Prindërit/kujdestarët që zgjedhin që studentët e tyre të kthehen te mësimi ballë për ballë, pranojnë që:

Të kontrollojnë çdo ditë shëndetin e studentëve të tyre. Edhe pse për momentin nuk është e nevojshme të bëjnë check-in elektronik, familjet duhet t'i mbajnë nën vëzhgim studentët e tyre para se t'i dërgojnë në shkollë. Është shumë e rëndësishme që studentët të qëndrojnë në shtëpi nëse shfaqin simptoma të COVID-19.

Përveç kësaj, familjet duhet që:

- Të njoftojnë menjëherë drejtorin e shkollës nëse dikush në familje ka simptoma ose del pozitiv me COVID-19
- T'u përmbahen udhëzimeve të Divizionit Shëndetësor të Rrethit Oakland në lidhje me karantinimin për ekspozimin ndaj COVID-19, pavarësisht nëse ekspozimi është brenda shkollës apo jashtë saj

- T'u përmbahen të gjitha protokolleve dhe procedurave të përcaktuara nga Rrethi Shkollor Troy, duke përfshirë kërkesën që studentët të mbajnë maska gjatë gjithë kohës* si edhe masave të tjera për lehtësimin e situatës.

Këto procedura mund të ndryshohen në varësi të kushteve dhe avancimit të praktikave. Prindërit dhe studentët do të njoftohen për çdo ndryshim. Familjet dhe studentët që zgjedhin të mos i ndjekin këto kërkesa do të kenë mundësi alternative, ku përfshihet mësimi në një mjedis virtual.

**shiko pjesën për Mjetet personale mbrojtëse - Maskat, për informacion në lidhje me "pushimin nga maskat" dhe rastet e rralla që përjashtohen nga rregullorja jonë për maskat.*

PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE PËR KTHIMIN TE MËSIMI BALLË PËR BALLË

Studentët që kthehen te mësimi ballë për ballë duhet të ndjekin protokollet dhe procedurat e përcaktuara nga Rrethi Shkollor Troy, ku përfshihet mbajtja e maskës gjatë gjithë kohës*, përpjekjet e tjera për lehtësimin e situatës dhe pritshmëritë për sjelljen. *Këto procedura mund të ndryshohen në varësi të kushteve dhe avancimit të praktikave. Familjet dhe studentët do të njoftohen për çdo ndryshim. Ata që zgjedhin të mos i ndjekin këto kërkesa do të kenë mundësi alternative, ku përfshihet mësimi në një mjedis virtual.*

NDRYSHIMET MES PERSONAVE TË VAKSINUAR DHE ATYRE TË PAVAKSINUAR

CDC dhe OCHD përcaktojnë disa ndryshime në protokoll mes personave të vaksinuar plotësisht dhe atyre të pavaksinuar.

Një person konsiderohet plotësisht i vaksinuar 2 javë pas dozës së dytë të vaksinave Pfizer ose Moderna kundër COVID-19, ose 2 javë pas një doze me vaksinën Johnson & Johnson kundër COVID-19.

Sipas CDC, personat e vaksinuar plotësisht ka më pak të ngjarë të infektohen me COVID-19 dhe ka më pak të ngjarë të kenë nevojë për shtrim në spital nëse infektohen (këtu përfshihet edhe Delta dhe variantet e tjera të njohura). I nxitim të gjithë studentët, stafin dhe familjet që të vaksinohen menjëherë sapo të jetë e mundur.

Personat e vaksinuar plotësisht:

Personat e vaksinuar plotësisht nuk ka nevojë të karantinohen kur ekspozohen ndaj COVID-19 për sa kohë nuk kanë simptoma. Kjo do të thotë që, nëse studenti juaj identifikohet si kontakt i afërt i një rasti me COVID në shkollë, ai mund të vazhdojë të vijë në shkollë për sa kohë nuk ka simptoma.

PROTOKOLLET E SIGURISË DHE SIMPTOMAT QË DUHEN PASUR PARASYSH

Që të vazhdojmë të mos lejojmë përhapjen e rasteve brenda shkollave, do të përdorim përsëri një "kontroll të simptomave" me dy kategori të zhvilluar nga OCHD dhe CDC. Familjet duhet të përdorin kriteret e mëposhtme për të përcaktuar nëse duhet ta dërgojnë apo jo një fëmijë në shkollë. Po të njëjtat kritere do t'i përdorim kur dërgojmë në shtëpi një student simptomatik:

Ekzistojnë dy kategori simptomash që duhen pasur parasysh dhe disa kërkesa të ndryshme për kthimin:

Nëse studentët/stafi ka NJË simptomë në kategorinë e parë (shfaqje e kollës, gulçim, vështirësi në frymëmarrje, humbje e ndjesisë së shijimit ose nuhatjes), duhet t'i mbani ata në shtëpi DHE të bëni një test për COVID-19, i cili duhet të dalë negativ, për ta lejuar të kthehet ose t'i mbani në shtëpi për një periudhë izolimi prej 10 ditësh, të mos kenë nevojë për ilaçe për ulje të temperaturës dhe simptomat të jenë përmirësuar që të lejohen të kthehen në shkollë.

Nëse studenti/stafi ka DY simptoma në kategorinë e dytë (Temperaturë 100.4 °F ose 38.8 °C, ose më e lartë, ethe, dhimbje muskulore, dhimbje koke, dhimbje fyti, këputje, diarre, përzierje ose të vjella, rufë ose sekrecione nga hundët) duhet t'i mbani në shtëpi DHE të bëni një test për COVID-19, i cili duhet të dalë negativ, për ta lejuar të kthehet ose t'i mbani në shtëpi për një periudhë izolimi prej 10 ditësh, të mos kenë nevojë për ilaçe për ulje të temperaturës dhe simptomat të jenë përmirësuar që të lejohen të kthehen në shkollë.

E RE: Nëse studentët/stafi kanë NJË simptomë në kategorinë e dytë (përveç temperaturës ose të vjellave), ai mund të shkojë në shkollë, por ju kërkojmë që ta vëzhgoni me kujdes për të parë nëse shfaqen simptoma. Studentët/stafi që ka temperaturë ose të vjella mund të kthehet në punë/shkollë pasi ka qenë pa temperaturë/të vjella për 24 orë pa pasur nevojë për ilaçe për ulje të temperaturës dhe pasi simptomat janë përmirësuar. Nuk është e nevojshme të bëhet testi për një simptom, përveç nëse zbatohen sa më sipër.

KONTROLLUESI I SIMPTOMAVE

KATEGORIA 1

Shfaqje e kollës

Gulçim

Vështirësi në frymëmarrje

KATEGORIA 2

Temperaturë 100.4 gradë ose më e lartë

Ethe

Dhimbje muskulore

Humbje e ndjesisë së shijimit ose nuhatjes

Dhimbje kokes

Dhimbje fyti

Këputje

Diarre

Përzierje

Të vjella

Rrufë

Sekrecione nga hundët

1. **JO TESTET E SHPEJTA:** Ne nuk i pranojmë testet e shpejta si vërtetim që dikush nuk është me COVID-19. Për të dhënë vërtetim të një testi negativ, duhet të bëni një test PCR.
2. **DIAGNOSTIKIMI ALTERNATIV (I PËRDITËSUAR):** Nëse një student dërgohet në shtëpi me simptoma që kanë lidhje me COVID dhe nuk testohet për COVID, mund të pranohet një diagnozë alternative nëse studenti është vizituar fizikisht te mjeku dhe ai shkruan një diagnozë të qartë dhe aktuale, e cila shpjegon simptomat (i.e. strep, mono, etj.)
3. **RREGULLORJA PËR VËLLEZËRIT OSE MOTRAT:** Nëse një student qëndron në shtëpi ose dërgohet në shtëpi me simptoma që kanë lidhje me COVID, TË GJITHË VËLLEZËRIT OSE MOTRAT e atij studenti duhet të shkojnë në shtëpi/të qëndrojnë në shtëpi derisa rezultatet e testit PCR të dalin negative. Nëse një prind ose kushdo tjetër që jeton në të njëjtën shtëpi ka simptoma që lidhen me COVID dhe është në pritje të rezultateve të testit të COVID, të gjithë studentët e asaj shtëpie duhet të qëndrojnë në shtëpi derisa rezultatet e testit PCR të dalin negative. Në të dyja rastet, familjet duhet të japin vërtetim të rezultateve negative.
4. **DUHET TË RAPORTOHEN MUNGESAT/NDRYSHIMET NË SHKOLLË:** Nëse në një ditë të caktuar studenti juaj duhet të shkojë fizikisht në shkollë dhe nuk shkon, DUHET TË TELEFONONI LINJËN PËR PJESËMARRJEN në shkollën e studentëve dhe të tregoni simptomat që ka studenti dhe pse nuk po shkon në shkollë .

Nëse studentët nuk shkojnë personalisht në shkollë sepse janë karantinuar për shkak të ekspozimit jashtë shkollës, duhet të telefononi shkollën dhe ta vini në dijeni.

Nëse shkolla e ka këshilluar studentin që të karantinohet, nuk ka nevojë të telefononi.

E rëndësishme—nuk duam që asnjë të vijë në shkollë i sëmurë për çfarëdo lloj arsyeje. Asnjë student NUK do t'i llogariten mungesat, me kusht që puna të bëhet.

5. **SHKURTIMI I KARANTINËS:** Sipas udhëzimeve të CDC, nuk ka mundësi testimi për të shkurtuar një karantinë. Ju lutem të shikoni pjesën e mëposhtme për më shumë informacion.

KARANTINA DHE IZOLIMI

Njerëzit që janë vaksinuar plotësisht nuk ka nevojë të karantinohen nëse nuk kanë simptoma. Ata që kanë dalë pozitiv me COVID-19 brenda 90 ditëve të fundit, nuk ka nevojë të karantinohen. Sido që të jetë, kërkohet vërtetim i statusit të vaksinimit ose rezultati pozitiv i një testi laboratorik.

Nëse një student ose person nga stafi identifikohet si kontakt i afërt me dikë që ka COVID-19 por nuk ka simptoma, ai duhet të **KARANTINOHET për 10 ditë pas ditës së fundit të ekspozimit** (numërimi fillon të nesërmen—studenti kthehet në shkollë në ditën 11.) *Ju lutem të mbani parasysh se kjo periudhë përcaktohet nga OCHD dhe mund të ndryshohet për shkak të varianteve ose faktorëve të tjerë në zonën tonë.*

KARANTINIMI do të thotë që:

- Duhet të qëndroni në shtëpi 24/7 për 10 ditë
- Të vëreni simptomat dhe të ruani gjatë gjithë kohës distancën fizike (të paktën 6 feet ose 2 metra) nga të tjerët.
- Të kontrolloni dhe mbani shënim temperaturën 2 herë në ditë.

SHKURTIMI I PERIUDHËS SË KARANTINËS: Sipas CDC, ju mund ta pakësoni kohën që ju duhet për t'u karantinuar deri në 7 ditë nëse merrni bëni testin PCR për COVID në ditën 5 ose më vonë dhe ai del negativ. Kjo do të thotë që mund të bëni përsëri një etest (përsëri në ditën 5 të karantinës ose më vonë) dhe të ktheheni në shkollë dhe në aktivitetet normale në ditën 8, me kusht që të mos keni simptoma. Kushdo që ka simptoma duhet të qëndrojë në shtëpi.

SHËNIM i ri: OCHD NUK ndjek metodën që ka rekomanduar MDHHS për testimin e përditshëm për t'u kthyer nga karantina, ndaj për momentin nuk do ta implementojmë këtë. Në rast se kjo ndryshon, do të komunikojmë me familjet dhe stafin.

Nëse një student ose pjesëtar i stafit del POZITIV për COVID-19, ai duhet të **IZOLOHET** për të paktën 10 ditë nga nisja e simptomave ose nga data e testimit.

IZOLIMI përfshin çdo gjë që përfshin karantina, por do të thotë edhe që duhet të

qëndroni larg nga pjesëtarët e tjerë të familjes. OCHD thotë se kushdo që është në izolim duhet të përpiqet që:

- Të qëndrojë në një dhomë të veçuar nga pjesëtarët e tjerë të familjes.
- Të përdorë banjë të veçantë nëse është e mundur. Nëse banja është e përbashkët, mbajini furçat e dhëmbëve dhe dezinfektojni të gjitha sipërfaqet pas çdo përdorimi.
- Mos ndani me të tjerë gjëra personale, si enët, gotat, filxhanët
- MOS hani, mos rrini me të tjerët dhe mos kaloni kohë në të njëjtën dhomë me ta

E RE: NUK ËSHTË E MUNDUR TË BËHET IZOLIMI I PLOTË NËSE JETOHET NË TË NJËJTËN SHTËPI ME TË TJERË

Në shumicën e rasteve, sidomos me vëllezërit e motrat dhe prindërit që kujdesen për fëmijët e vegjël, është e pamundur të bëhet izolimi i plotë për 10 ditë. Për shkak të rritjes së infektivitetit me varianin Delta dhe numrit të vëllezërve e motrave që dalin pozitivë, duhet të supozojmë që studentët dhe stafi nuk mund të izolohet plotësisht për të gjithë periudhën 10-ditëshe kur një pjesëtar i familjes del pozitiv.

Sipas direktivave të OCHD/CDC, kjo do të thotë që **çdo student/staf i pavaksinuar duhet të qëndrojë në shtëpi** gjatë periudhës së izolimit 10-ditor të personit pozitiv me COVID, **MË PAS fillon karantina 10-ditore.**

Rezultati i kësaj është se vëllezërit e motrat dhe fëmijët e njerëzve pozitivë me COVID do të jenë larg shkollës (dhe do të rrinë në shtëpitë e tyre) për të paktën 20 ditë, përveç nëse janë të vaksinuar plotësisht. **PËRDITËSIM:** Nuk ekziston mundësia e testimit para kohe për kontaktet e ngushta të familjes.

OCHD shpjegon se arsyetimi pas kësaj qëndron në faktin se çdo pjesëtar i familjes që nuk mund të izolohet nga një person pozitiv me COVID është vazhdimisht i ekspozuar gjatë të gjithë periudhës 10-ditore të izolimit, dhe më pas mund të sëmuren vetë dhjetë ditë më vonë.

UDHËTIMI

PËRDITËSIM: Aktualisht nuk ka kërkesa karantine për udhëtimet jashtë ose brenda vendit. I nxitim të gjitha familjet që udhëtojnë qoftë jashtë vendit, qoftë brenda vendit, që të kenë kujdes dhe t'i kontrollojnë studentët e tyre për sëmundje.

Kërkesat e karantinës për udhëtimin mund të ndryshohen gjatë vitit.

PLANI MËSIMOR NË KARANTINË

PËRDITËSIM: Rrethi Shkollor Troy e kupton rëndësinë që ka vazhdimi i ndjekjes së mësimit nga studenti ndërkohë që është në karantinë ose gjatë një sëmundjeje që zgjat. Besojmë se është e rëndësishme të ofrohet mundësi e mirë për lidhje të drejtpërdrejtë çdo ditë me shkollën dhe të jepet ndihmë në lidhje me pyetjet dhe detyrat. Shkolla fillore dhe shkolla e mesme do të duken paksa ndryshe për shkak të fazës zhvillimore të nxënësit dhe aftësive për të punuar i pavarur. Të dyja planet do të përfshijnë përdorimin e Koordinatorëve të Mirëqenies, të cilët do t'i mbështetin studentët gjatë karantinës. Mësuesi i klasës (në çdo nivel klase/në çdo lëndë) është personi përgjegjës për studentët në klasën e tij. Koordinatori i mirëqenies punon në bashkëpunim me mësuesin e klasës. Ky program është suplementar dhe është një burim i mëtejshëm për studentët.

SHKOLLA FILLORE

Në shkollën fillore, mësuesit e klasës do t'i postojnë të gjitha materialet dhe detyrat në lidhje me shkollën. Koordinatorët e mirëqenies në shkollën fillore do të përfshijnë një mësues në çdo nivel klase. Studentëve që janë në karantinë ose që kanë një sëmundje që zgjat, do t'u jepet një link në Zoom që të kenë mundësi të ndjekin mësimin e WC për të ndjekur mësimin drejtpërdrejt në momente të ndryshme gjatë ditës shkollore. WC do të jetë gjithashtu i disponueshëm për studentët një orë para ose pas ditës shkollore për t'u përgjigjur pyetjeve ose për t'u dhënë mësim studentëve që janë në karantinë. Ju lutem të mbani parasysh se koordinatori i mirëqenies mund të mos jetë mësuesi i klasës së studentit tuaj. Mësuesit e klasës së stii ose të saj do të jenë në dispozicion për t'u lidhur edhe me email.

PËRDITËSIM SHËNIM PËR STAFIN: Tani kemi punësuar koordinatore mirëqenieje në të gjitha nivelet e klasave dhe programi është gati për t'i ndihmuar studentët.

Shkolla e mesme

Në nivelin e shkollës së mesme dhe të lartë, caktimet dhe materialet do të postohen në Schoology nga mësuesit e klasës. Koordinatorët e mirëqenies të shkollës së mesme do të përbëhen nga një mësues për çdo lëndë të rëndësishme (matematikë, anglisht, shkencë, studimet sociale). Në nivelin e shkollës së mesme, çdo koordinatori i mirëqenies do të jetë i disponueshëm drejtpërdrejt në Zoom për një orë mësimore në ditë, dhe studentët që janë në karantinë mund të hyjnë në atë klasë për ndihmë dhe asistencë të drejtpërdrejtë për çdo temë. Oraret do të jepen gjatë javës së dytë të shkollës, megjithatë orari WC do të funksionojë pak a shumë si një ditë e zakonshme

shkolle, vetëm me orët mësimore të domosdoshme. Për shembull, matematika mund të jetë ora e parë, anglishtja e dyta, e kështu me radhë. Studentët mund ta bëjnë punën vetë nëse zgjedhin të mos hyjnë në Zoom, megjithatë kjo mundësi do të jetë e disponueshme në secilën shkollë për të gjithë studentët që janë në karantinë ose që kanë një sëmundje që zgjat. Mësuesit e caktuar të klasës së studentëve janë në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të ndihmuar me email

E kuptojmë që ky plan mund të mos jetë perfekt për të gjithë studentët, por ai ofron mundësi për familjet në nevojë për shkak të sëmundjeve afatgjata ose karantinës, siguron një mjedis të shëndetshëm në shkollë dhe ndihmon në mirëqenien për të gjithë, si dhe ndihmon mirëqenien akademike dhe social-emocionale të studentëve. Ndërsa viti avancoi, do të vazhdojmë t'i rishikojmë vazhdimisht planet mësimore në karantinë për të parë nëse është e nevojshme të bëhen rregullime.

MJETET PERSONALE MBROJTËSE - MASKAT, PLEXIGLASS, ETJ.

Për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e komunitetit të shkollave tona, të gjithë studentët, stafi dhe vizitorët në parashkollor përmes programeve post-sekondare duhet të mbajnë maskë kur ndodhen brenda godinave të shkollës dhe kur hipin në autobus. Këtu përfshihen edhe aktivitetet jashtëshkollore dhe klubet.

Maskat plastike, shamitë dhe qaforet nuk janë mjete të përshtatshme që zëvendësojnë maskat. Maskat duhet të përmbushin kërkesat e rekomanduara nga CDC, të puthiten mirë, të jenë prej cope të thurur dendur dhe të mos kenë hapësira, vrima, rrjeta ose zona të tjera ku mund të depërtojë drita.

Mësuesit dhe stafi do të nxiten të bëjnë "pushime" të shkurtra nga maskat duke përdorur hapësirat e jashtme. Nëse keni pyetje ose shqetësime në lidhje me pushimet nga maskat, ju lutem të kontaktoni mësuesin e fëmijës ose drejtorin e ndërtesës.

Pritet që stafi dhe studentët t'i sigurojnë vetëm maskat e tyre. Maskat prej lecke të punuara me dorë duhet të lahen çdo ditë. Maskat njëpërdorimëshe duhet të hidhen. Studentëve që kanë harruar maskën do t'u jepet një maskë njëpërdorimëshe për ta përdorur gjatë ditës.

Studentët që e heqin qëllimisht maskën ose përpiqen t'i pengojnë studentët e tjerë ose stafin të mbajnë maskë, do të disiplinohen dhe kjo mund të përfshijë kërkesën për të kaluar në mësimin virtual.

Përjashtime të rralla ndaj kërkesës për mbajtjen e maskës mund të bëhen për studentët me aftësi të kufizuara të dokumentuara nga mjeku, të cilat e bëjnë të pamundur mbajtjen e saj (p.sh. studentët që nuk mund ta heqin dot vetë maskën, etj). Familjet

nxiten që të praktikojnë mbajtjen e maskave me studentët në mënyrë që ata të mësohen me to. Nëse besoni se studenti juaj është një përjashtim i tillë mjekësor, ju lutem të kontaktoni zyrën e inspektorit në lidhje me kërkesat për dokumentacion para se të kontaktoni mjekun për t'u siguruar që keni dokumentet e duhura. Nuk do të merren në konsideratë përjashtime të tjera.

NDARËSET PREJ PLEXIGLASS

Në klasa do të merren të gjitha masat që studentët të jenë të kthyer të gjithë në të njëjtin drejtim dhe nuk do të vendosen ndarëse prej plexiglass në bankat ose vendet e punës të studentëve. Megjithatë, mësuesit do të kenë të gjithë mundësinë të përdorin një ndarëse pleksiglassi kur punojnë shumë afër studentëve (për shembull, gjatë konferencave të shkrimit).

HIGJIENA

Ndërtesat do të pajisen me stacione të përshtatshme për larjen dhe dezinfektimin e duarve në koridore, mensa, banja, etj.

Furnizimet (pecetat prej letre, sapunët, dezinfektuesit e duarve, facoletat, koshat e plehrave) do të kontrollohen çdo ditë dhe do të pajisen sipas nevojës.

Dezinfektuesit e duarve do të jenë të disponueshëm në të gjitha klasat dhe në zyrën kryesore, të cilat do të furnizohen nga TSD. Familjeve mund t'u kërkohet që të dërgojnë donacione shtesë me higjenizues duarsh gjatë vitit.

Përkujtues për larjen e duarve dhe pushime për larjen e duarve do të vendosen në të gjitha ndërtesat.

HAPËSIRAT, LËVIZJET DHE HYRJET

Rrethi Shkollor Troy do t'i largojë fizikisht bankat dhe vendet e punës së studentëve sa më lart njëri-tjetrit që është e mundur. Kërkesat e Departamentit të Arsimit të Miçiganit për vitin 2021-22 (180 ditë shkolle/1098 orë) nënkuptojnë se klasat tona do të kthehen në numrat e tyre të zakonshëm. Kjo do të thotë që nuk është gjithnjë e mundur një distancë e caktuar mes studentëve, por ne punojmë fort drejt distancës tre feet ose një metër sa herë që është e mundur.

Aty ku është e mundur, të gjitha vendet e punës së studentëve do të vendosen në mënyrë të tillë që studentët të jenë të kthyer në të njëjtin drejtim. Më poshtë janë disa

shembuj të klasave të mesme dhe fillore të përgatitura me distancë prej tre feet ose një metri mes studentëve:



Figura 1 Klasa e mesme



Figura 2 Klasa fillore

Disa klasa fillore kanë vende pune që janë të përbashkëta me dy ose më shumë studentë. Do të punojmë me klasat për ta përdorur sa më mirë hapësirën e disponueshme, duke shkëmbyer mobilet për të ndihmuar sa më shumë në distancimin fizik mes studentëve:



PROTOKOLLET PËR PASTRIMIN DHE DEZINFEKTIMIT

Direktivat e fundit të CDC përcaktojnë se COVID-19 transmetohet kryesisht përmes ajrit dhe jo nëpërmjet sipërfaqeve.

Pastrimi i të gjitha ndërtesave, përdorimi i produkteve të miratuara nga EPA, do të bëhet çdo ditë. Në rast se dallohet një rast i COVID në klasë, ajo zonë do të dezinfektohet brenda së njëjtës dite.

Makineritë Vectorfog për dezinfektim me mjegull janë blerë dhe janë vendosur për t'u përdorur në çdo ndërtesë shkolle në rast se ndodh një rast i COVID:

https://youtu.be/mx3_0TR57Jc



PROTOKOLLI PËR MBËRRITJEN, TABELAT DHE KORRIDORIN

Në secilën ndërtesë të shkollës janë vendosur tabela për t'i kujtuar studentët dhe stafin për të ruajtur distancën fizike, për të mbajtur maska dhe për të pasur higjienë të mirë. Në të gjitha ndërtesat, numri i vizitorëve do të jetë i kufizuar, megjithatë në numra të kufizuar mund të përdoren vullnetarë në varësi të kushteve aktuale.

Në nivelin e shkollës së mesme, këtë vit do të përdoren dollapët me çelës.

Prindërit e studentëve të shkollës së mesme duhet të kuptojnë se distancimi social mund të mos jetë i mundur në korridore midis orëve të mësimi, por koha kalimtare nuk do të konsiderohet "ekspozim kontakti të ngushtë" siç përcaktohet nga standardi i OCHD prej 15 minutash kontakti brenda 3 feet ose 1 metër (shiko më poshtë në lidhje me protokollin për rastet e dyshuara të COVID).

HVAC DHE AJRIMI I NDËRTESAVE

Rrethi Shkollor Troy ka investuar mbi 10 milionë \$ në gjashtë vitet e fundit për ngrohjen, ajrimin dhe sistemet e kondicionimit të ajrit (HVAC) në të gjitha shkollat tona. Ky investim, së bashku me masat e tjera për kontrollin e infeksionit, si distancimi fizik, larja e duarve dhe maskat, mund të ndihmojnë parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Ja pse: Ndryshe nga sistemet e ngrohjes dhe ftohjes në shtëpi, të cilat vihen në punë vetëm derisa arrihet një temperaturë e caktuar, sistemet tona HVAC punojnë pa ndërprerje gjatë orarit të punës në godina për të siguruar lëvizje dhe qarkullim të vazhdueshëm të ajrit. Sistemet HVAC të TSD janë projektuar që të futin vazhdimisht në ndërtesa 20% ajër të freskët nga jashtë. EPA thotë se ajrimi i përshtatshëm me ajrin e jashtëm është i domosdoshëm për të pakësuar përqendrimin e kontaminantëve në ajër, duke përfshirë edhe viruset.

Sistemi juaj HVAC në shtëpi qarkullon të njëjtin ajër brenda shtëpisë suaj dhe nuk sjell ajër të freskët nga jashtë, ja pse shumë pronarë shtëpish blejnë pajisje portative me filtra HEPA ose drita UV në përpjekje për të bllokuar kontaminantët ose për të dezinfektuar ajrin.* Sistemet HVAC të TSD nuk përdorin filtra HEP sepse ata nuk japin rezistencë të madhe dhe nuk lejojnë futjen e ajrit të jashtëm në ndërtesë. Në vend të kësaj, sistemet tona HVAC përdorin filtra me vlerë raportimi të efikasitetit minimal (MERV) me vlerësime 8 deri në 13, të cilët përsëri filtrojnë kontaminantët por edhe sigurojnë mjaft ajër të freskët të vazhdueshëm.

** Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se filtrat HEPA nuk janë zgjidhje perfekte kur bëhet fjalë për COVID-19. Këta filtra janë bërë që të bllokojnë 99.97% të grimcave që janë 0.3 mikron. Kjo do të thotë se jo të gjitha viruset mund të bllokohen me filtrimin HEPA. Grimcat e COVID-19 janë grimca sferike me diametër 0.125 mikrone. Grimcat më të vogla janë 0.06 mikrone dhe më të mëdhatë janë 0.14 mikrone. Përveç kësaj, filtrat HEPA janë më pak të efektshëm në hapësira ku ka aktivitet të vazhdueshëm (p.sh. hapja/mbyllja e dyerve ose hyrja/dalja e njerëzve).*

AUTOBUSI DHE TRANSPORTI I STUDENTËVE

Në transportin me autobus të siguruar nga TSD nuk është e mundur të ruhet një distancë e caktuar mes studentëve. Familjet që zgjedhin të përdorin këtë transport e kuptojnë se studentët ka të ngjarë të jenë më afër njëri-tjetrit për periudha të caktuara gjatë udhëtimit me autobus, edhe pse do të bëhet çdo përpjekje për t'i distancuar fizikisht studentët sa më shumë të jetë e mundur. Mund të përdoren grafikë karrigesh për të ndihmuar në gjurmimin e kontakteve.

Studentëve do t'u kërkohet të mbajnë maska gjatë gjithë kohës që udhëtojnë me autobus, në përputhje me urdhrin federal. Për ata që harrojnë maskat, do të jepen maska njëpërdorimëshe.

Në të gjithë autobusët, dritaret do të jenë të hapura, nëse e lejon moti.

DREKA / SHËRBIMI I USHQIMIT

Dreka është falas për të gjithë studentët e këtij viti, falë një granti nga USDA. Megjithatë, studentët janë të mirëpritur të marrin me vete drekën, me kusht që të përmbushin kërkesat e shkollave për alergjinë.

I nxitim fort të gjitha familjet e studentëve, të cilët zakonisht pranohen për drekë falas dhe me çmim të reduktuar, që të bëjnë një aplikim për drekë falas dhe me çmim të reduktuar: Bërja e këtij aplikimi do të thotë që ju mund të keni të drejtë të merrni edhe përfitime të tjera, si për shembull tarifat falas ose me çmim të reduktuar të pjesëmarrjes së studentëve, EBT pandemike dhe ndihma të tjera.

Studentët do të hanë drekën në lokalin e shkollës. Do të inkurajohet përdorimi i hapësirës së jashtme, me kusht që moti ta lejojë dhe të ketë mbikëqyrje të përshtatshme. Kur është e mundur, do të përdoren hapësira alternative për t'i përhapur studentët gjatë drekës në godina dytësore. Studentët e fillorës do të ulen në për drekë me grupin e klasës së tyre.

Pyetjet në lidhje me konfigurimet dhe procedurat për drekën duhet t'i bëhen drejtorit të shkollës.

PUSHIMET E VOGLA / PUSHIMI JASHTË

Nëse e lejon moti, të gjithë studentët e shkollës fillore do të marrin pjesë në pushimin jashtë. Për momentin, studentëve nuk do të ndahen në grupe gjatë pushimit dhe nuk do të kërkohet mbajtja e maskave.

Mësuesit e të gjitha klasave në të gjitha shkollat do të nxiten që t'i nxjerrin studentët jashtë për të bërë pushim nga maskat.

PROTOKOLLET PËR RASTET E COVID-19

Të gjitha protokollet për rastet e dyshuara ose pozitive të COVID-19 janë përgatitur në bashkëpunim me Divizionin Shëndetësor të Rrethit Oakland për të parandaluar përhapjen në komunitet dhe për të mbrojtur studentët dhe stafin tonë.

Çdo incident do të trajtohet në varësi të rastit nga Divizioni Shëndetësor i Rrethit Oakland. Më poshtë është një përmbledhje e zakonshme se çfarë do të ndodhë nëse raportohet një rast, por ju lutem të mbani parasysh se në varësi të rezultatit të investigimit, Divizioni Shëndetësor i Rrethit Oakland mund të vendosë që grupe më të mëdha njerëzish të karantinohen, duke përfshirë klasa të tëra ose ndërtesa të tëra shkolle.

PROTOKOLLI PËR RASTET E DYSHUARA TË COVID-19 NË KLASË

Nëse një student ka simptomat e COVID-19 gjatë ditës shkollore, studenti do të nxirret nga klasa dhe do të vendoset në një klasë më vete. (Shiko faqen 7 për simptomat dhe kërkesat specifike)

Prindërit/kujdestarët do të njoftohen dhe duhet të marrim masa që të vijnë ta marrin studentin menjëherë. Një pjesëtar i stafit do të monitorojë dhomën, por prindërit duhet të mbajnë parasysh se studentët e tjerë që kanë simptoma të ngjashme do të presin në të njëjtën dhomë.

Prindërve do t'u kërkohet që të telefonojnë mjekun dhe të lënë një takim për të bërë testin e COVID-19. (Takimet dhe pikat për bërjen e testeve përmes Divizionit Shëndetësor të Rrethit Oakland mund të gjenden këtu—dhe ato janë në dispozicion për të gjithë të rriturit dhe për çdo student nën moshën 18 vjeç që ka simptoma: <https://www.oakgov.com/covid/best-practices/sick-caring/Pages/testing.aspx>)

Studentët që dërgohen në shtëpi me simptoma të COVID-19 duhet të qëndrojnë në shtëpi derisa të bëjnë një prej të mëposhtmeve:

- 1) Studenti mund të japë një vërtetim të rezultatit negativ të testit PCR për COVID OSE
- 2) kanë kaluar 10 ditë që prej nisjes së simptomave dhe të paktën 24 orë ilaçe për ulje të temperaturës.

VËLLEZËRIT DHE MOTRAT/PJESËTARËT E FAMILJES DUHET TË KARANTINOHEN/IZOLOHEN NË SHTËPI NDËRSA PRESIN REZULTATET E TESTIT TË NJË PJESËTARI TË FAMILJES.

Nëse studenti fillestar del pozitiv, shikoni më poshtë protokollin për rastet pozitive.

PROTOKOLLI PËR RAPORTIMIN E RASTEVE POZITIVE TË COVID NGA PRINDËRIT/KUJDESTARËT

Prindërit/kujdestarët e studentëve që dalin pozitivë me COVID-19 duhet të njoftojnë menjëherë drejtorin e godinës duke i bërë një telefonatë shkollës. Ju lutem t'i tregoni sekretarit se duhet të flisni me drejtorin ose me administratorin për një problem urgjent (mos lini mesazh). Në raste të rralla ku një prind e merr vesh pas orarit të shkollës, ai/ajo duhet t'i dërgojë menjëherë një email drejtorit dhe të komunikojë me telefon në mëngjes nëse drejtori nuk e ka kontaktuar ende. Kjo vlen pavarësisht nëse studenti është drëguar në shtëpi nga shkolla apo ka bërë test për ndonjë arsye tjetër.

Privatësia e studentit do të mbrohet dhe nuk do të bëhet i ditur emri i tij, përveç OCHD-së dhe punonjësve të shkollës, të cilët janë përgjegjës për të ndihmuar kthimin e studentit në shkollë. Këtu përfshihet mësuesi i fëmijës dhe/ose një person i caktuar nga stafi.

Studentët që dalin pozitivë duhet të ndjekin rekomandimin e OCHD dhe të izoloohen për një periudhë prej 10 ditësh pas nisjes së simptomave ose pasi rezultati i testit ka dalë negativ, nëse janë pa simptoma.

PROTOKOLLI PËR NJOFTIMIN E RASTEVE TË DYSHUARA ME COVID

Kur një prind njoftin TSD për një rezultat pozitiv me COVID-19, duhet të njoftojmë Divizionin Shëndetësor të Rrethit Oakland, i cili fillon të punojë menjëherë me TSD për të verifikuar rezultatin dhe me ne për të gjurmuar kontaktet.

Duke përdorur grafikët e karrigeve në klasë, ne do të komunikojmë me OCHD se cilët studentë ulen brenda një distance prej tre feet ose një metri nga studenti që ka dalë pozitiv. Këta studentë konsiderohen kontakte të afërta, siç përcaktohet për ata që qëndrojnë brenda tre feet ose një metri për 15 minuta ose më shumë.*

*Ngaqë çdo student dhe pjesëtar i stafit në shkollë do të jetë plotësisht me maskë, kemi mundësi të përdorim distancën prej tre feet ose një metër për karantinën. Nëse nuk do të kishim mbajtjen universale të maskës, do të na kërkohej të përdornim një distancë prej 6 feet ose 2 metrash për karantinën, dhe kjo do të bënte që më shumë studentë të ndiqnin mësimin nga shtëpia.

KONTAKTET E AFËRTA: Nëse sipas grafikëve tanë për vendosjen e karrigeve, fëmija juaj identifikohet si kontakt i afërt në godinat tona, tëherë drejtori i shkollës ose dikush i caktuar prej tij do t'ju informojë. Ky njoftim do t'ju vijë me email, por do të njoftoheni që të kontrolloni email-in qoftë me telefon qoftë me një mesazh. Është e rëndësishme që familjet të kontrollojnë email-in kur ndodh kjo, pasi studentët që identifikohen si kontakte të afërta nuk mund të kthehen në shkollë derisa të mbarojë karantina.

Për shkak të ligjeve për privatësinë, nuk do t'ju jepet emri i studentit ose i stafit që ka dalë pozitiv. Do t'ju jepen udhëzime se si të filloni një karantinë 10-ditore (shikoni pjesën për karantinën për mundësinë e shkurtimit të kohës së karantinës). Presim që OCHD të na japë informacione të mëtejshme.

Si stafet e TSD, ashtu edhe investiguesit e OCHD mund të identifikojnë studentë të tjerë që konsiderohen kontakte të afërta. Këtu mund të përfshihen studentë që kanë udhëtuar me autobus së bashku ose që kanë pasur kontakt jashtë ditës shkollore. Nëse jeni njoftuar nga OCHD se fëmija juaj ka pasur kontakt të afërt me dikë që ka dalë pozitiv, duhet të njoftoni drejtorin e shkollës.

Të gjithë studentët që janë verifikuar si kontakt i afërt me një person që ka dalë pozitiv me COVID, duhet të ndjekin rekomandimin e OCHD duke u karantinuar për 10 ditë dhe duke qenë të vëmendshëm ndaj simptomave. (Ju lutem të shikoni pjesën e karantinës për informacion në lidhje me kërkesat dhe mundësinë për të shkurtuar kohën e karantinës.)

RASTET NË SHKOLLË (PËRDITËSIM): Të gjitha rastet e COVID-19 do të postohen në kohë në panelin për COVID në faqen e internetit të TSD. Vetëm familjet e studentëve që janë kontakte të afërta do të njoftohen personalisht për një rast në godinën e shkollës. Të gjitha familjet duhet të kontrollojnë rregullisht panelin për COVID-19 në faqen e internetit të TSD për të parë një listë të rasteve në çdo ndërtesë. Vetëm studentët që janë kontakte të afërta duhet të marrin masa. Asnjë student ose staf tjetër nuk ka nevojë të karantinohet. Por të gjitha familjet duhet të jenë të vëmendshme ndaj studentëve të tyre për të parë nëse shfaqen simptoma. Ju lutem të mbani parasysh se ne nuk marrim njoftim për studentët që ndjekin mësimin virtualisht, që infektohen me COVID gjatë pushimit në shkollë dhe nuk mund t'i informojmë prindërit ose stafin për rezultatet.

VIZITORËT, GRUMBULLIMET DHE AKTIVITETET JASHTËSHKOLLORE

Numri i vizitorëve në shkollat tona do të jetë i kufizuar. Prindërit që kanë takime (mbledhjet IEP, takimet me mësuesin ose administratorin, etj.) do të jenë të mirëpritura brenda godinave, edhe pse do të inkurajohen takimet virtuale kur është e mundur. Derisa të dhënat për COVID-19 të përmirësohen, vizitat jo të domosdoshme (për

shembull, për të ngrënë drekë me një student ose për të shoqëruar një student brenda ndërtesës) nuk do të lejohen. Janë duke u zhvilluar protokolle për punën vullnetare në shkolla. Eventet në shkallë të gjerë ku pritët të marrin pjesë një publik i gjerë, si për shembull netët e kurrikulës, do të jenë virtuale.

Prindërit që duhet të lënë gjëra për studentët, duhet ta bëjnë këtë duke i lënë ato në sheshpushim, duke shkruar emrin e studentit sipër dhe duke njoftuar sekretarin e shkollës me citofon. Nuk lejohen dërgesa të ushqimeve nga restorantet ose dërgesa nga jashtë.

Ekskursionet do të lejohen duke përdorur procesin ekzistues të aprovimit nga administrata. Të gjitha ekskursionet do të shqyrtohen për sa i përket sigurisë dhe protokolleve. Do të shmangen grumbullimet e të gjithë personave në ndërtesë, megjithatë do të lejohen mbledhjet në shkollën e mesme, duke përdorur hapësira të mëdha dhe sa më shumë distancë mes studentëve.

Eventet e jashtme, si dita në fushë, vrapimet argëtuese, etj. do të mbahen. Klubet dhe aktivitetet jashtëshkollore do të bëhen fizikisht.

Për momentin, të gjitha aktivitetet e zakonshme (Homecoming, etj.) do të bëhen sipas programit, edhe pse mund të përdoren vende alternative.

ATLETIKA

Atletika do të ndjekë direktivat e përcaktuara nga MHSAA, qoftë për praktikën, qoftë për konkursin, si edhe siç zbatohet sipas urdhrave përkatës të OCHD për emergjencat shëndetësore.

PËRDITËSIM: Duke filluar nga 29-8-21, për shkak të urdhrit të OCHD, të gjithë atletët, trajnerët, stafi dhe spektatorët brenda ndërtesave duhet të mbajnë maskë ndërsa marrin pjesë ose ndjekin eventet sportive ose stërvitjet në ambientet e brendshme në TSD. Për më shumë informacion lidhur me rregullat dhe protokollat për aktivitetet e atletikës, ju lutem të kontaktoni trajnerin e fëmijës suaj ose drejtorin e atletikës.

Prindërit e atletëve studentë që dalin pozitivë ose që u shfaqen simptoma të COVID-19 duhet të njoftojnë drejtorin për pjesëmarrjen e tyre në një skuadër kur raportojnë rastin, dhe gjithashtu të informojnë trajnerin e tyre. Trajnerët/drejtorët e atletikës do të bëjnë koordinimin me drejtorin e shkollës për t'u siguruar që pjesëtarët e duhur të skuadrës të njoftohen.

COVID-19 RASTET NË SHKOLLË DHE TË DHËNAT E RRETHIT OAKLAND

Prindërit dhe stafi duhet të jetë në dijeni se, pavarësisht kontrolleve të rrepta shëndetësore, përsëri kemi raste të COVID-19 në ndërtesat tona. Nuk mund të detyrojmë me forcë izolimin jashtë shkollave, prandaj synimi ynë është të pakësojmë përhapjen në komunitet (transferimi i COVID-19 nga një person te një tjetër) brenda shkollave tona.

Në vitin 2020-21 ishim të suksesshëm në parandalimin e përhapjes brenda shkollave tona falë bashkëpunimit me familjet, studentët dhe stafin. Për të qenë të suksesshëm këtë vit, sidomos me variantin Delta si varianti dominues në zonën tonë, kemi përsëri nevojë për ndihmën e komunitetit për parandalimin e përhapjes si jashtë, ashtu edhe brenda shkollave tona.

Nëse doni të mbeteni të përditësuar për rastet e COVID në shkollat tona dhe për të dhënat që studiojmë brenda rrethit, kemi një faqe të posaçme në faqen tonë të internetit (www.troy.k12.mi.us)

Si përfundim u kërkojmë të gjitha familjet që të marrin masa parandaluese në jetën e tyre. Shkollat tona janë një reflektim i komunitetit tonë, ndaj kemi nevojë për ndihmën tuaj që ta mbajmë mësimin fizik ballë për ballë sa më të sigurt.

Gjithashtu jemi të vetëdijshëm për vështirësitë në shëndetin mendor që mund të përjetojnë studentët gjatë kësaj pandemie. Psikologët, konsulentët dhe punonjësit socialë të shkollave tona janë këtu për t'ju ndihmuar nëse keni nevojë për ndihmë (kontaktoni drejtorin ose përdorni linkun TSD Cares në faqen e internetit të rrethit shkollor). OCHD ka burime të dobishme për këdo që përjeton stres, ankth ose probleme të shëndetit mendor: <https://www.oakgov.com/covid/best-practices/mental-health/Pages/default.aspx> Nëse vini re se diçka po ndryshon me fëmijën tuaj, kontaktoni mjekun e tij. Rrjeti Shëndetësor i Komunitetit në Oakland ka një linjë të hapur 24/7 për rastet e krizave: 800-231-1127.

Siç e thamë që në fillim, të dhënat dhe drejtimi nga ekspertët e shëndetit publik na ndihmojnë të marrim vendime për sa i përket masave për lehtësimin e situatës. Jemi mirënjohës për bashkëpunimin me familjet teksa punojmë gjatë këtyre kohëve të vështira që të mbrojmë studentët dhe stafin, si dhe të mos çënojmë mësimin. Jemi të përkushtuar që t'ju mbajmë të informuar gjatë gjithë kohës.


KONKLUZIONE DHE HAPAT E RADHËS

Kuptohet që do të lindin pyetje të mëtejshme gjatë vitit shkollor. Jemi të gatshëm të komunikojmë rregullisht me ju, por ju lutem ndihuni të lirë të kontaktoni në çfarëdo

momenti drejtorin e shkollës ose administratorin e zyrës qendrore. Të gjitha përditësimet do të postohen në faqen tonë të internetit te pjesa me titull COVID-19 në faqen e internetit të TSD: www.troy.k12.mi.us.

Ky manual do të përditësohet sipas nevojës dhe do të postohet tek e njëjta pjesë në faqen e internetit.

Si gjithmonë, e çmojmë ndihmën e të gjithë komunitetit tonë ONE Troy.



Rich Macheksy, Ed.D.
Inspektor
Rrethi Shkollor Troy